



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL



THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje me

Centrifugë elektrike për nxjerrjen e mjaltit,
vaskë për nxjerrjen e mjaltit dhe bazament
plastike për koshere (dysHEME - Antivarroa).

(Subvencione ne kuadër te sektorit te Bletarisë)

Gjakovë, Gusht 2026

Në kuadër të mbështetjes për zhvillimin e sektorit të bletarisë dhe modernizimin e kapaciteteve prodhuese të bletarëve në Komunën e Gjakovës, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR), në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, shpall këtë thirrje publike me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në prodhimin e mjaltit dhe përkrahjes së bletarëve me pajisje bashkëkohore.

Ftohen bletarët e Komunës së Gjakovës të aplikojnë për përkrahje me njëren nga pakot e pajisjeve në vijim:

- **Centrifugë elektrike për nxjerrjen e mjaltit dhe një vaskë për nxjerrjen e mjaltit (32 perfitues);**
- **Centrifugë elektrike për nxjerrjen e mjaltit dhe dymbëdhjete (12) bazamente plastike për koshere – dysHEME antivarroa (5 perfitues);**

Kriteret e pranueshmërisë :

- Aplikuesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës;
- Të jetë aplikues në Pagesa Direkte në kuadër të MBPZHR-së për vitin 2026;
- Të ketë së paku 30 koshere bletësh të deklaruara në Pagesa Direkte për vitin 2026;
- Aplikuesit duhet të kenë të shënuar në çdo koshere numrin identifikues të fermerit (NIF);
- Bletari mund të aplikojë vetëm për një pako të pajisjeve;
- Përfituesit duhet të bashkëfinancojnë vlerën e subvencionit me së paku 20%;
- Aplikuesit të mos kenë përfituar subvencione nga Komuna në vitin paraprak dhe në vitin aktual;
- Përparësi do t'u jepet bletarëve që nuk kanë përfituar nga skemat komunale gjatë viteve të fundit;
- Përparësi kanë gratë fermere, të rinjtë dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë;
- Ndarja e përfituesve do të bëhet në mënyrë proporcionale sipas pesë (5) rajoneve të Komunës së Gjakovës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Fotokopje të letërnjoftimit;
- Kopje të Numrit Identifikues të Fermerit (NIF);
- Vërtetim mbi tatimin në pronë;
- Dëshmi të aplikimit në Pagesa Direkte për vitin 2026;
- Deklaratë nën betim.

Formulari i aplikimit mund të merret në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Gjakovës.

Afati i aplikimit

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është nga **07.08.2026** deri më **21.08.2026**.

Mënyra dhe adresa për dorëzimin e aplikacioneve

Aplikacionet e kompletuara me dokumentacionin e kërkuar dorëzohen në **Arkivin e Komunës së Gjakovës**, në adresën:

Komuna e Gjakovës

Rr. "UÇK".

50000 Gjakovë

Mënyra e vlerësimit të aplikacioneve

Vlerësimi i aplikacioneve do të zhvillohet në dy faza:

Faza e parë – Shqyrtimi administrativ

Në këtë fazë do të bëhet verifikimi i aplikacioneve dhe dokumentacionit të dorëzuar, me qëllim të konstatimit nëse aplikacionet janë të plota dhe i përmbushin kërkesat administrative të përcaktuara në këtë thirrje publike. Vetëm aplikacionet që i plotësojnë kërkesat administrative do të kalojnë në fazën e dytë të vlerësimit.

Faza e dytë – Vlerësimi i kritereve

Aplikacionet që kalojnë shqyrtimin administrativ do të vlerësohen sipas kritereve të përcaktuara në këtë thirrje publike. Vlerësimi do të bëhet përmes sistemit të poentimit të kritereve të miratuara, ndërsa dokumentacioni administrativ nuk do të jetë pjesë e kësaj faze të vlerësimit.

Kushtet dhe mënyra e parashtrimit të pyetjeve sqaruese

Të gjithë aplikuesit e interesuar mund të parashtrojnë pyetje sqaruese lidhur me këtë thirrje publike gjatë periudhës së aplikimit.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural do të ofrojë sqarimet e nevojshme në kohë, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjithë aplikuesit.

Kushtet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave

Aplikuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesë ndaj rezultateve të kësaj thirrjeje publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ankesat paraqiten me shkrim në **Arkivin e Komunës së Gjakovës**, brenda afatit ligjor nga dita e publikimit të rezultateve.